



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018  
SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT

Lënda: Histori e thelluar

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

**Shënim:** Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

• **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	D	A	C	C	D	A	D	D	C	D

• **Pyetjet me zhvillim**

**Pyetja 11**                      **4 pikë**

**Shpjegimi:** Xhon Loku krijoi një sistem ku përputheshin disa ide si ajo e vetëqeverisjes, ideja se njeriu nuk lind as i mirë as i keq, se të gjithë lindin të lirë dhe të barabartë. Sipas tij të drejtat natyrore që duhet të gëzojë një njeri janë:

- a) E drejta për të jetuar.
- b) E drejta për të qenë i lirë.
- c) E drejta për të patur pronë.

**Roli i qeverisë sipas Xh. Lokut:**

Çdo qeverisje duhet të mbrojë të drejtat natyrore të njeriut. Nëse nuk ndodh kështu, qytetarët kanë të drejtë natyrore të përmbysin qeverinë.

<b>4 pikë</b>	Nëse shkruan tre të drejtat natyrore sipas Lokut dhe rolin e qeverisë.
<b>OSE</b>	
<b>3 pikë</b>	Nëse liston dy të drejtat natyrore sipas Lokut dhe rolin e qeverisë.
<b>2 pikë</b>	Nëse liston një nga të drejtat natyrore sipas Lokut dhe rolin e qeverisë.
<b>1 pikë</b>	Nëse liston një nga të drejtat natyrore sipas Lokut <b>OSE</b> rolin e qeverisë.
<b>0 pikë</b>	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 12**                      **3 pikë**

- Faktor përcaktues në zhvillim ishte natyra e regjimit qeverisës dhe i politikave, pra funksioni i shtetit varej nga aftësitë personale dhe përkushtimi i perandorëve.
- Selia e perandorit ishte “Qyteti i Ndaluar”, nëpërmjet të cilit shprehej madhështia dhe paprekshmëria e perandorit.
- Sistemi administrativ ishte jo eficient, nëpunësit ishin të papërgjegjshëm dhe korrupsioni u rrit dukshëm
- Perandorët kishin një koncept të gabuar. Ata e quanin Kinën si “qendër të botës” e superiore ndaj vendeve të tjera.
- Roli jo mbështetës i evropianëve në këtë proces.

<b>3 pikë</b>	Nëse rendit tre nga faktorët.
<b>OSE</b>	
<b>2 pikë</b>	Nëse rendit dy nga faktorët.
<b>1 pikë</b>	Nëse rendit një nga faktorët.
<b>0 pikë</b>	Nëse përgjigjet gabim <b>OSE</b> nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 13**                      **3 pikë**

- Roli i veçantë i shtetit (i cili ndërtoi “ndërmarrjet model” që më pas iu shitën me çmime të ulëta firmave private)
- Zbatimi i teknologjisë moderne e cila rriti së tepërmi prodhimin.
- Bankat dhe institucionet financiare (si rrjedhojë e ndjenjës së lartë të kursimit që kishin japonezët), siguronin në vazhdimësi fonde monetare për investime nga ana e kapitalit privat.
- Shkalla e arsimit të popullsisë ishte e lartë – 40% e japonezëve- treguesi më i lartë në Azi.
- Ndjenja e krenarisë kombëtare për ta bërë Japoninë vend lider ekonomikisht dhe ushtarakisht.

<b>3 pikë</b>	Nëse rendit tre nga faktorët.
<b>OSE</b>	
<b>2 pikë</b>	Nëse rendit dy nga faktorët.
<b>1 pikë</b>	Nëse rendit një nga faktorët.
<b>0 pikë</b>	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 14**                      **2 pikë**

**Vendimi:** Vendimi kryesor që u mor ishte hapja e shkollës “Normale” në Elbasan.

**Qëllimi:** Përgatitja e mësuesve për shkollat shqipe që do të hapeshin.

**2 pikë**                      Nëse shkruan vendimin dhe qëllimin.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse shkruan vendimin **OSE** qëllimin.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15**                      **3 pikë**

- Mosdhënia e ndihmës financiare të premtuar nga Fuqitë e Mëdha.
- Zgjedhja në krye të qeverisë e Turhan Pashë Përmetit, që kishte shërbyer si ambasador i Perandorisë Osmane në Rusi për vite me radhë dhe nuk e njihte realitetin politik.
- Dhënia e dy posteve të rëndësishme si ministër i Luftës dhe i Punëve të Brendshme Esat Pashë Toptanit.
- Ekzistenca e një organi tjetër qeverisës paralel KNK.
- Shpërthimi i kryengritjes së Shqipërisë së Mesme.
- Shpallja e të ashtuquajturës “autonomi të Vorio Epirit”.
- Shpërthimi i Luftës së I Botërore.

**3 pikë**                      Nëse shkruan tre nga arsyet.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse shkruan dy nga arsyet.

**1 pikë**                      Nëse shkruan një nga arsyet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16**                      **3 pikë**

- Nuk bëri zgjedhje për të legjitimuar pushtetin e tij.
- Nuk spastroi radhët e administratës nga përkrahësit e A. Zogut.
- Nuk gjeti mbështetjen politike dhe financiare në arenën ndërkombëtare.
- I vetmi shtet që e njohu ishte Bashkimi Sovjetik.
- Nuk arriti të kryente reformën agrare.

**3 pikë**                      Nëse shkruan tre nga arsyet.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse identifikon dy nga arsyet.

**1 pikë**                      Nëse identifikon një nga arsyet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 17

3 pikë

*Të përbashkëtat*

Morën pjesë nacionalistë dhe komunistë.

Në të dyja u deklarua:

- Për luftë kundër pushtuesit, për një Shqipëri të pavarur.
- Forma e regjimit do të vendosej pas lufte.

*E veçanta:*

Në Konferencën e Pezës u vendos krijimi i organizatës Fronti Nacionalçlirimtar me përfaqësues si nga PKSH-ja edhe nga forcat nacionaliste jo komuniste.

Në Konferencën e Mukjes u vendos krijimi i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë me përfaqësues nga FNC dhe Balli Kombëtar.

Çështja e Kosovës u prek vetëm në Mbledhjen e Mukjes.

## Arsyeja

- Partia Komuniste nuk donte ta ndante pushtetin me asnjë forcë tjetër politike.
- Ndikimi jugosllav ishte aq i madh sa nuk mund të pranonte vendimet e Mukjes që e preknin në dy drejtime: së pari në çështjen e mos ndarjes së pushtetit me forca të tjera politike dhe së dyti, në lidhje me zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

3 pikë

Nëse shkruan një të përbashkët dhe një të veçantë, si edhe identifikon një nga arsyet pse konferenca e Mukjes nuk gjeti zbatim.

**OSE**

2 pikë

Nëse shkruan një të përbashkët dhe një të veçantë OSE jep një të përbashkët edhe identifikon një nga arsyet pse konferenca e Mukjes nuk gjeti zbatim OSE jep një të veçantë dhe identifikon një nga arsyet pse konferenca e Mukjes nuk gjeti zbatim.

1 pikë

Nëse jep një të përbashkët **OSE** një të veçantë **OSE** identifikon një nga arsyet pse konferenca e Mukjes nuk gjeti zbatim.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 18

3 pikë

- Kina përkrahu politikisht udhëheqjen komuniste të Shqipërisë.
- Nevoja e Shqipërisë për ndihma ekonomike dhe ushtarake.
- Kina ishte një vend me potencial të fuqishëm ekonomik që mund të ndihmonte ekonominë shqiptare
- Kina ishte larg dhe nuk mund të shprehte ndonjë kërcënim për pavarësinë e Shqipërisë apo rrëzimin e pushtetit.

3 pikë

Nëse shkruan tre nga arsyet.

**OSE**

2 pikë

Nëse shkruan dy nga arsyet.

1 pikë

Nëse shkruan një nga arsyet.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 19**                      **3 pikë**

- a) Së pari, ajo luajti një rol të rëndësishëm në luftën antifashiste nacionalçlirimtare.
- b) Arriti të krijojë struktura ushtarake të frytshme si dhe organe pushteti, që shkallë – shkallë morën formën e një qeverie të përkohshme në vend dhe u shtrinë kudo.
- c) Lëvizja Nacional Çlirimtare në Shqipëri u njoh si e vetmja forcë luftarake nga aleatët antifashistë.
- d) PKSH u bë drejtuesja e vetme duke mos e ndarë pushtetin me asnjë forcë politike në vend.
- e) PKSH eliminoi çdo frymë opozite në gjirin e saj dhe në shkallë kombëtare.

**3 pikë**                      Nëse liston tre nga treguesit.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse liston dy nga treguesit.

**1 pikë**                      Nëse liston një nga treguesit.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20**                      **3 pikë**

Kushtetuta e vitit 1976 me dispozitat që përmbante shënoi hapa prapa sepse:

- a) Forma e pronësisë nuk do të ishin më private, kolektive dhe shtetërore por vetëm shtetërore dhe kolektive (eliminohet prona private).
- b) Pushteti ishte një, i pandarë. U legjitimua bashkimi i tre pushteteve në një të vetëm (legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor).
- c) Kushtetuta sanksionoi karakterin ateist të shtetit komunist.
- d) Theksohej roli i luftës së klasave si forcë lëvizëse e shoqërisë në kuadër të shtetit të diktaturës së proletariatit dhe përjetësonte RPSSH.
- e) Mbështetja në forcat e veta ku u sanksionua izolimi ndërkombëtar i vendit.
- f) Nuk lejohej asnjë formë e marrjes nga jashtë e huave, kredive apo financimeve.

**3 pikë**                      Nëse jep tre nga argumentet.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse liston dy nga argumentet.

**1 pikë**                      Nëse liston një nga argumentet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.